

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

NR. 342 . date 14.7. 2000

PER LËVIZJEN PARALELE DHE NGRITJEN NË DETYRË TË NËPUNËSIT CIVIL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 14, 15 dhe 29, të ligjit nr.8549, datë 11. 11. 1999, " Për statusin e nëpunësit civil", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli I Ministrave

V E N D O S I:

1. Procedurat e planifikimit për plotësimin e vendeve të lira, të parashikuara nga pika 1 deri në 5, të vendimit nr.231, datë 11.5.2000, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin nd shdrbimin civil dhe periudhën e provës", shërben edhe për lëvizjen paralele dhe për ngritjen në detyrë.
2. Shpallja e konkurimit për lëvizjen paralele përmban keto të dhëna:
 - a) Një pershkrim te shkurter të vendit të punës: pozicioni, sektori, drejtoria dhe institucioni;
 - b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojnë kandidatët, në përputhje me pershkrimin e punes per vendin e lirë;
 - c) Pozicionet në shërbimin civil, që përfitojnë. nga proceura e levizjes paralele;
 - ç) Një listë te dokumenteve që duhet të paraqiten dhe vendin ku do të paraqiten;
 - d) Afati deri kur do të paraqiten dokumentat, i cili duhet të jetë jo më i vogël se 30 ditë nga data e botimit të shpalljes për konkurim;
 - dh) Mënyrën dhe kohën kur do të shpallet lista e kandidatëve" që do t'i paraqiten eprorit te drejtpërdrejtë, sipas pikës 5 të këtij vendimi.
3. Departamenti i Administratës Publike, me shpenzimet e institucionit që ka vendin e lirë, boton shpalljen e vendit të lirë në dy gazeta kombëtare, me qarkullim më të madh. Në institucionet e pavarura botimi bëhet nga departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit.
4. Departamenti i Administratës Publike bën verifikimin e kandidatëve, të cilët, sipas fotokopjeve të dokumenteve të paraqitura përmbushin kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim. Në institucionet e pavarura verifikimi bëhet nga departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit.
5. Kandidatët, që plotësojnë kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim, renditjen, nga Departamenti i Administratës Publike, në listën e kandidatëve sipas rendit alfabetik dhe i paraqiten eprorit të drejtpërdrejtë.
6. Brenda 3 ditëve nga shpallja e listave, personat e interesuar mund t'i paraqesin ankesat ne Departamentin e Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, ose në departamentin, drejtorinë, seksionin apo zyrën e personelit, për institucionet e pavarura. Ankesat zgjidhen brenda 3 ditëve nga marrja e tyre. Paraqitja e ankesave të mësipërme nuk prek të drejtën e ankimit në komisionin e shërbimit civil.
7. Dy ditë mbas zgjidhjes së ankeseve apo kalimit të afatit për zgjidhjen e tyre, Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës qendrore, apo departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, për institucionet e pavaruara, ia dërgojnë listën e kandidatëve, që plotësojnë kërkesat e veçanta, eprori të drejtpërdrejtë, përkatës. Kandidatët nuk I nënshtrohen testimit para komiteve ad hoc.
8. Eprori i drejtpërdrejtë, sipas klasës së nëpunësit civil, përpara se të zgjedhë njerin nga kandidatët të paraqitur, zhvillon, si rregull, një bashkëbisedim me secilin prej tyre.

9. Vendimi i eprorit të drejtpërdrejtë duhet të jetë i motivuar dhe të bazohet në parimet e barazisë, të mirëbesimit dhe të mosdiskriminimit.
10. Nëse në përfundim të procedurave të pikës 7 të këtij vendimi Departamenti i Administratës Publike, për insitucionet e administratës qendrore, apo departamenti, drejtoria, seksioni apo zyra e personelit, për insitucionet e Pavarura, vëren se asnjëri nga kandidatët nuk përmbush kërkesat e veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim, fillon procedurën e ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë, ekzistues.
11. Shpallja e konkurimit për ngritjen në detyrë përmban të dhënat sipas pikës 2 të këtij vendimi, përveç shkronjës "c", ku përcaktohen pozicionet e shërbimit civil, që përfitojnë nga ngritja në detyrë.
12. Poçedurat e ngritjes në detyrë është e njejtë me atë të pranimit në shërbimin civil, sipas vendimit nr.231, datë11.5.2000, të Këshillit të Ministrave. "Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

ILIR META